

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-720/022	Data: Datum: 29.09.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në dispozitat e Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 02 Nr.46/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Administratë Komunale, për shpalljen e thirrjes publike për organizimin e aktivitetit: “Organizimi 16-të ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas” për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 02Nr.46/2022 e datës 21.09.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Administratë Komunale, për shpalljen e thirrjes publike për organizimin e aktivitetit “Organizimi 16-të ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas”, për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve në fushën e Administratës Komunale.
2. Për shpalljen e Thirrjes publike si në pikën 1 të këtij vendimi do të zbatohen dispozitat e Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare nga thirrja publike do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Administratës Komunale-nënprogrami buxhetor 16517 i barazisë gjinore.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe përgjegjës për zbatimin e tij është Drejtoria për Administratë Komunale.
5. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ


